



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Datë 13/01/2020

Drejtuar: Operatorit ekonomik “ALBDESIGN PSP” shpk
Adresa: Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim” - mallra
Referenca e procedures: REF-38023-10-02-2019
Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje dokumentacioni, për Bashkinë e Tiranës”
Fondi limit: 2.500.000 (dy milion e pesëqind mijë) lek pa TVSH
Afati i dorëzimit të mallit: Operatori ekonomik fitues duhet të lëvrojë mallin brenda 2 (dy) muajve nga lidhja e kontratës.
Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 28/ 10/ 2019, ora 11:30
Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 40 datë 07 Tetor 2019
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori ekonomik “Albdesign PSP” shpk** **NUIS L51819005Q**
Vlera e ofertës pa TVSH– 1.923.584 (një milion e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë
Vlera e ofertës me tvsh– 2.308.300,8 (dy milion e treqind e tetë mijë e treqind, presje tetë) lekë.
 - 2. Operatori ekonomik “Kristalina KH” shpk** **NUIS K411501002D**
Vlera e ofertës pa TVSH– 2.451.950 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë
Vlera e ofertës me tvsh– 2.942.340 (dy milion e nëntëqind e dyzetë e dy mijë e treqind e dyzetë) lekë.
 - 3. Operatori ekonomik “G&L Print” shpk** **NUIS L02017016R**
Vlera e ofertës pa TVSH– 2.252.300 (dy milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind) lekë
Vlera e ofertës me tvsh– 2.702.760 (dy milion e shtatëqind e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë.
 - 4. Operatori ekonomik “Inpress” shpk** **NUIS L52122014L**
Vlera e ofertës pa TVSH - 2,213,500 (dy milion e dyqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekë
Vlera e ofertës me tvsh– 2,656,200 (dy milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë.
- Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

1. Operatori ekonomik "G&L Print" shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "G&L Print" shpk është s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Nga verifikimi i bërë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik „Climacasa“ shpk u konstatua se:

1. Operatori ekonomik G&L Print ka paraqitur bilancin për vitin 2017 dhe 2018 të pakonfirmuar nga Tatimet të vulosura dhe firmosura vetëm nga operatori ekonomik "G & L Print" shpk duke rënë në kundërshtim me kriterin e përcaktuar në pikën 2.2 gërma (b) të kriterëve të vecanta për kualifikim rubrika "kapaciteti ekonomik dhe financiar" pika 2.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", gërma (b), ku citohet se:
Ofertuesi i mundshëm ekonomik duhet të paraqesë:
*"Kopje të vërtetuara të balanceve të dy viteve të fundit (2017, 2018) nga data e zhvillimit të tenderit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, **të konfirmuara nga ky autoritet**";*
2. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike sipas shtojcës 7 duke rënë në kundërshtim me kriteret e vecanta për kualifikim pika 2/1 gërma (d) pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.
3. Operatori ekonomik sa më sipër cituar nuk ka paraqitur deklaratë sipas së cilës operatori i shpallur fitues do të realizojë printimet pasi të jetë konsultuar me AK diuke rënë në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit.
4. Operatori ekonomik sa më sipër cituar nuk ka paraqitur deklaratë për marrjen përsipër të transportit të mallit pranë magazinës së AK-së duke rënë në kundërshtim me kriteret vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit, pika 2.3 e Kapacitetit Teknik, nënpika 2.3.4.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".* Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), përcakohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik "ALBDESIGN PSP" shpk** me adresë: Rruga "Çerçiz Topulli", objekti Nr.17, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 1.923.584 (një milion e nëntëqind e njëzetë e tre mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH dhe 2.308.300,8 (dy milion e

treqind e tetë mijë e treqind, presje tetë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 06.12.2019.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur ankesë nga operatori ekonomik “Inpress” shpk në datë 16.12.2019 të cilës Autoriteti Kontraktor i ka kthyer përgjigje në datë 23.12.2019 në rrugë elektronike dhe me postë, shoqërisë ankimuese. Operatori ekonomik “Inpress” shpk nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimimit në Komisionin e Prokurimit Publik